

Te dashura motra e vllazër Stubllas, mbi e nën moshen 40 vjeçare,

**U R I M E**

**40 VJETORI**

**I SHUGURIMIT TË KISHES TUAJ !**

**02.02.1970 – 02.02.2010**



Nga heshtja e thellë prej largimit nga famullia ime e lindjes, marr guximin të ju ftoj në një ditë **FALËNDERIMI** pas 40 vjet të shfrytzimit të objektit të shenjt të famullisë së Stubllës.

Ky **F a l ë n d e r i m**, i përcjellur me lutje për të gjithë ata që kanë vdekur dhe për ata që ende janë gjallë, le të jet nxitje e përhershme që gjeneratat e reja të mos e harrojnë:

- a) **z. Dom Dedë Ramaj-n**, iniciatorin e ndërtimit të kishës;
- b) **don Luka Cirimotic-in**, realizuesin deri në finale të sajë;
- c) **don Jakë Prenku-n**, vazhdimin e ndërtimit të kishës shpirtërore;
- d) **don Rrok Gjonleshaj-n**, renovuesin dhe krijuesin e infrastruktures përcjellëse;
- e) **fenë e gjallë** të gjyshërve e babave dhe bashkëshortëve të tyre. Fe, e cila u dëshmuua me flijimin e plotë për ndërtimin e atij Objektit të Shenjt; dhe
- f) **vullnetin e mirë të donatorëve** të njohur e të pa njohur.

Të parët tanë ishin të dobët, por djersa nuk u kursye as prej trupit të dobët të tyre, ishin të varfër por edhe varferin e tyre e shndrruan në një pasuri të madhe shpirtërore, e cila vazhdon të rritet, e ajo është:

- 1) 2100 pagëzime në Kishen e Re (i pari i pagëzuar: z. Isak Shin Luz Demaj, para shugurimit, dhe i pari pas shugurimit të sajë z. Gjon Frrok Nue Toma);
- 2) 1500 krezmime;
- 3) 1210 kurorëzime ( të parët: Nikollë Qeshk Luz Ukaj me Tereze Qerkini para shugurimit me 11.01.1970, dhe Pal Lush Prenk Ukaj me Jozefinen Tuniq pas shugurimit të Kishës, me 24.08.1970)
- 4) Mbi 20 meshë të para të meshtarëve nga Stublla, e mbi 50 rregulltare që në atë kishë u pagëzuan dhe u edukuan për thirrjen që e ushtrojnë në shumë vende të botës;
- 5) Mbi 15.000 meshë e veprime tjera fetare që u kryen në atë vend të shenjt.

Meshtarëve, bijë të Stubllës, ju porosisë ta lexoni Aktin e Ordinariatit Ipeshkvnor nr 787/1988 dhe te meditonin mbi fytyren tejet të ëmbël të Pajtorit të Kishes: Shën Jozefit!

URIMI IM PER JU: të qëndroni me fe e falënderim mbi themelet e gjakut të derdhur të martirëve, dhe në vazhdimësi të qëndrueshme të dëshmimit të fesë si janë të qëndrueshëm gurët e shuguruar para 40 viteve!

Bashkëvendasi i juaj

Në Prizren, 31.01.2010  
Kola

Don Aleksander